



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:055046

Datë: 14.01.2021

Numri i dokumentit: 01406746

PKR.nr. 55/2002

NË EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda, duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi dhe anetaret e trupt gjykues Islam Thaqi e Sahit Boroci, me sekretaren juridike Fikrete Destani, ne çështjen penale te te akuzuarit L. Xh , K. Viti, te cilin e mbron Av. Blerim Halimi nga Gjilani, për shkak të veprës penale vrasje nga neni 30 al.2 pika 3 te LPK-se e lidhur me nenin 24 al. 2. Te LPJ-se, e sipas aktakuzes se Prokurorise Publike te Qarkut ne Gjilan, PP.nr. 65/2001, e dt. 06.08.2001, e pas mbajtjes e shqyrtimit gjyqsor me dt. 11.01.2021 , shpalle, ndersa me date 13.01.2021 perpilon :

AKTGJYKIM

Ndaj te pandehurit L. Xh nga babai T. dhe nëna Sh., e lindur R., i lindur me dt... ne Viti, tani me vendbanim ne, K. Viti, k ate kryer shkollen e mesme, I pa pune, I martuar, baba I 5 femijve, I gjendjes ekonomike te varfer, shqiptar, shtetas I Republikes se Kosoves.

-konform nenit 364 par. 1 pika 1.3 dhe 454 par 1 te KPPRK-se,

LIROHET NGA AKUZA SEPSE

Nuk eshte vertetuar, se te pandehurit L. Xh dhe Xh. Sh. ne kohe, vend dhe ne menyre te pershkruar si ne dispozitivin nr. I. te dispozitivit kur eshte privuar nga jeta F. A nga ana e te pandehurit te pare A. Xh I kan ndihmuar me veprime konkrete ne realizimin e pasojes, ne ate menyre qe viktimen tri dite rresht e kan kerkuar para dates 16.05.2001, dhe ate ne dhe Viti, e qe ditën kritike e kan percjelle viktimen dhe kur ai ka arritur te pompa e benzines ...

pas marrjes se karburanteve duke u nisur I kan dal perpara automjetit, I pandehuri I dyte dhe I tret I kan hapur dyert e automjetit e kan detyruar me force te ndjerin te dale nga automjeti dhe ne kete menyre I kan krijuar kushte te pandehurit te pare qe te realizoi qellimin dhe pas nji fjalosje te shkurter ndermjet tyre, I pandehuri I pare me revolen e cekur ne dispozitivin I. ka shtene ne te ndjerin nga goditjet e marruna ne te njejtjen dite ka vdekur ne spitalin e B. ne Sojeve.

-me c'rast kishte për të kryer vepren penale, ndihme ne kryerjen e vepres penale vrasje nga neni 30 al. pika 3 te LPK-se e lidhru me nenin 24. Al.2 lidhur me al. 1 te LPJ-se.

Shpenzimet lidhur me kete lende mbesin ne barre te mjeteve buxhetore te KGJK-se.

ARSYETIM

Prokuroria Publike e Qarkut ne Gjila, me dt. 06.08.2001, ka ngritur aktakuzen PP. nr.65/2001, ndaj të akuzuarve; A. Xh, per shkak te veprave penale vrasje nga neni 30.al.2 pika 3 te LPK-se dhe vepren penale mbajtje pa leje e armes nga neni 8.6 lidhur me nenin 8.2 te RRegullores nr. 7/2001, L. Xh e Xh.Sh per shkak te vepres penale vrasje nga neni 30 al.2 pika 3 te LPK-se e lidhur me nenin 24 al. 2. Te LPJ-se dhe ka kerkuar qe te njejtit te shpallen fajtor dhe denohen sipas ligjit.

Per te akuzuarit A. Xh ka perfunduar procedura penale ne baze te Aktgjykimit te Gjykates se Qarkut ne Gjilan P.nr.61/2001, te dates 3. Tetor 2001, sipas te cilit eshte shpallur fajtor per veper penale vrasje nga neni 30 al. 2 pika 5 te LPK-se dhe vepres penale posedim I armes pa leje ne baze te nenit 8 pika 2 lidhur me piken 6 te RRegullores nr. 7/2001,eshte denuar me denim unik prej 10 vite e 2 muaj, ndersa sipas Aktgjykimit Ap.nr.265/2001 te Gjykates Supreme te Kosoves te dates 24.01.2002, eshte ndryshuar aktgjykimi I Gjykates se Qarkut ne Gjilan dhe te njejtit I ka shqiptuar denim me burg ne kohezgjatje prej 12 vite.

Ndersa sa I perket te akuzuarit Xh. Sh, me aktgjykimin e permendur te Gjykates se Qarkut ne Gjilan, ndaj te njejtit eshte refuzuar akuza dhe eshte vertetuar nga Gjykata Supreme e Kosoves.

Per te akzuarin L.Gj, qeshtja eshte kthyer ne rigjykim.

I akuzuari L. Xh ne asnji faze te procedures nuk e ka pranuar vepren penale e cila I vihet ne barre.

Procedura e provave;

Deshmitari B. A, deklaroi se ka dhënë deklartë edhe në shqyrtimin e kaluar gjyqëso dhe mbetem në tërësi pranë asaj deklarate.

Ka qenë në vendin e ngjarjes kur ka ndodhë rasti, ka qenë me policën Shpresën.

Atë ditë kan qenë me veturë zyrtare në, duke u kthyer për në Viti , te një pompë e benzinës kan pa një grumbull njerzish, e njëri prej tyre ka qenë edhe tashmë i akuzuri L., i cii na ka dhanë shej mu ndal , jemi ndal kemi kontakti me L.. L. u ka thene se ka problem me tani të ndjerin, për shkak të një borgji dhe L. me një vlla të vetit ia kanë marr qelsat e kerrit për shkak të një borgji tani të ndjerit.

Po sa jan nal aty, kan njoftu edhe Stacionin Policor, ne policët kemi qenë duke biseduar me L. duke e pyetur për çfarë është problem. Viktima ka qenë në veturën e vet dhe derën e ka pasur të hapur, bile njëren këmbë e ka pas jashtë. Gjatë bisedës te tij me L., viktima ka dal prej veturës ndërsa ky e ka detyruar me hyrë në veturë, se e ka njohur që ka qenë problematik dhe i rrezikshëm dhe pas këaj ky (deshmitari) përsëri ka thirrë Stacionin Policor për ndihmë, se ka pas diku rreth 20 vet. Vllau i L. më dukete se e ka A. emrin, ka qenë mbështet për veture të viktimës dhe e ka fol një fjalë ‘ me hajna mos paq punë’ dhe në moment viktima ka dal prej veture dhe i ka mshu grusht në fytyrë, ku A. është rrëzuar. Ne moment edhe L. është kthyer nga viktima, sigurisht për me kap atë por unë nuk e kam lënë, e ka larguar prej atyhit dhe në atë momente, vetëm kur ka kërstitë alltia. Nuk e ka vrejtur se kush e ka gjuajtur, sepse ky ka qenë i kthyer nga L. dhe në ato momente kish pas met vet, për shkak se policja që ka qenë me te kishte hyrë në veturë për me e thirr bazën.

Kanë fillu njerzit me ik pas kërstitmës, ky e kam pas viktimën nja 5-6 metr larg dhe vetëm kur e kam parë të rrëzuar. Ky pastj e ka nxjerr revolen zyrtre dhe e ka drejtuar në drejtim të A., për shkak se ende e ka pas revolen në dorë. I dhashë urdhër për me lshu revolen . Aty nuk e ka lshuar menjëherë por është larguar nja 5-6 metra ma larg.

Kur e ka hedh revolen i ka thënë me u shtri për toke dhe në ato momente kanë ardhur njësit tjera për ndihmë nga Stacionet.

Viktima është marrë nga vetura e Policisë dhe është dërguar në ambullant në Viti për me i dhënë ndihmë mjeksore. Ky ka dëgjur 4-5 të shtëna sa i

kujtohet. Nuk i kujtohet qfarë revole ka qenë, por të krismet kanë qenë të një pas njëshme.

Në këtë fazë të procedurës prokurori i shtetit propozon që dëshmitari konform nenin 340 par 2 të hyjë nën betim.

Gjykata ka refuzuar propozimin prokurorit të shtetit që dëshmitari të jep dekartë nën betim, për arsye se prokurori i shtetit nuk ka dhënë asnjë arsye pse të bëhet deklarata nën betim, nga ana tjetër neni 340 par 1 thotë se betimi duhet të jipet para fillimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit, edhe për arsye se nga koha e kryerjes së veprës penale më 16.05.2001 kanë kalur afër 20 vite dhe detajet mund të jenë harruar. Dhe nga ana tjetër dëshmitari që në fillim të deklaratës së tij, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratave të dhëna në shqyrtimet gjyqësore.

Ne vazhdim dëshmitari ka deklaruar, se pasi e ka parë viktimën në tokë ky është marrë me A. siç e ka potencuar më herët. Aty i kanë gjetur tani të akuzuarin L.. Nuk e di me çka janë ardhë aty.

L. nuk ka pas në dorë asgjë. Kurfarë veprime tjera L. nuk ka bërë përveç që I ka shpjeguar më herët. Sipas L. motivi ka qenë një borgj që viktimia ia ka pas A. dhe L..

Prokurori i shtetit I ka propozuar gjykates, që për hirë të ekonomizimit të procedurës si dhe faktin që 2 dëshmtiarët S. A. dhe M. A janë të vdekur në anën tjetër dëshmitarja Sh. A, është jashtë shtetit, ka propozuar që deklaratat e tyre të lexohen.

Kete propozim gjykata e ka aprovuar, pas marrjes se mendimit edhe nga ana e Avokatit mbrojtës dhe të akzuarit.

Deklarata e dëshmitari S. A e dhënë më dt. 2 tetor 2001, ne shqyrtim gjyqsor, ne te cilen kishte deklaruar se është e vertet se ne momentin që ka ndodhur ngjarja ne pisten e pompes, ky ka qen B. ne zyre duke fol ne telefon dhe që B. ka degjuar krismet e revoles dhe menjihere ka dale. Ka pa se ne pisten e pompes ka patur shume njerz. Se si është zhvilluar ngjarja nuk e din.

Deklarata e dëshmitarit M. A e dhënë më dt. 2 tetor 2001. te dhene ne shqyrtim gjyqsor, ne te cilen ka deklaruar se është e vertet se ditën kritike rreth orës 10 ose 11, s aka qen duke punuar ne pompe, ka degjuar 3-4 krisma, se kush ka qit nuk e din, ngase nuk e ka pare, se ne ate kohe ka qen duke punuar rreth shitjes se benzines.

Deklarata e dëshmitari Sh. A, zyrtare policore e dhënë më dt. 2 tetor 2001, ne shqyrtimin gjyqsor, ka deklaruar se me 16 maj 2001, diku rreth ores 10;45 ka qen me veture te policies sebashku me kolegun B. A, duke u kthyer nga per Viti. Kan kaluar rreth pompes se benzines ... , kan vrejtur nji grumbull te djelmoshave, diku nja 7-10 veta. Nji person I cili ishte pak me larg nga grupi I djelmoshave, doli ne rruge dhe beri me dore qe ta ndalim veturen. Nga baza ne Viti kan kerkuar me radfiolidhje edhe nji patrulle te policies. Veturen e kan ndal nja 5-6 m nga grupi I personave . Kan shkuar drejte te akuzuarit L. X. Ne bisede e siper me te akuzuarin L., ai u ka treguar se shkaku I mosmarrveshjes eshte vetuar te cilen tani I ndjeri Faruk nuk ka dashur ta paguaj. Keta I kan thene te akuzuarit L. qe te pres deri sa te vine policia dhe ata do te merren me rastin. Me kete propozim u pajtua Lulzimi. Me te akuzuarit A. Xh dhe Xh. Sh nuk kan biseduar as kjo e as B. A.

Patrulla e policse ka ardhur pasi ka perfundu rasti. Te ndjerin F. e ka njohur si figure, por nuk e di kush e ka qit nga vetura e tij. Sa ishin duke biseduar me te akuzuarin L. Xh, aty ka ardhur tani I ndjeri F. I ka njoftuar se I akuzuari L. tani te ndjerit F. i aka borgj 1.500 dm. Po ashtu ne afersi ka qen edhe I akuzuari Xh. Sh, I cili krahun e majte I'a ka qitur mbi krahun e te ndjerit F. duke e larguar nga turma qe te mos beje fjale. Po ashtu ka thene se ndermjet vedi kan qen shoke. Po ashtu ne ato qaste nji person per mu I pa njohur, por si duket ka qen tani I akuzuari A., ka qen pas vetures dhe ne nji moment ka folur dicka, por nuk e din se cka. Atehere e ka pa se tani I ndjeri F. vrapoi ne drejtim te personit tjeter-te akuzuarit A., me te cilin jan rrahur, por nuk I ka pare se si. Edhe I akuzuari L. ka nderhy, por se cka ka bere nuk e din ngase aty u kriju nji tollovi, ku ka pas rreth 20-30 veta. Ateher kjo edhe tani deshmitari B. A e kan kapur L. Xh dhe e kan larguar nja 4-5 m dhe sa ishin te kthyer me shpine nga turma, kan degjuar krisma, por nuk e din sa krisma ka degjuar. Aty per aty I kan nxjerre armet dhe I kan drejtuar ne drejtim te tani te akuzuarit A. I cili ne dore e ka pas armen dhe kolegu B. A e ka urdhruar qe ta leshoi armen dhe I njehti leshoi armen dhe ka ecur disa hapa, e pastaj e ka pare se kolegu e ka prangosur, e ka urdhruar te akuzuarin qe te shtrihet per toke dhe me kete jan shtrire te gjithë per toke.

Leximi I shkresave;

-Procesverbali nga vendi ngjrrjes I perpiluar nga Gjykata e Qarkut ne Gjilan, sipas te cilit ngjarja ka ndodhur me date 16.05.2001 rreth ores 11,5 ne Viti afer Pompes se benzines ... prone e S. A. Ka ndodhur plagosja e tani te ndjerit F. I nga I cili nga plaget e marra ne te njejten dite ka vdekurt diku rreth ores 14,00 ne Spitalin e B... Ne vendngjarje eshte gjetur automjeti Porshe, kater gezhojate plumbave, ne gjashte vende shifen gjurmet e predhave te cilat e kan goditur shtresen e asfaltit, gjithashtu shifen gjurmet e

gjakut ne ne shtate vende, te gjitha keto jan gjetur para automjetit te udhtarve, ndersa mbrapa automjetit eshte gjetur nji pallto e lekures si dhe nji patike puma e kembes se majte te personit te rritur. Ne nji place te pompes se benzines ku ka material ndertimor jan gjetur tri gezhoja te revoles si dhe eshte gjetur mbi disa blloka revolja e ... e pak me large eshte gjetur nji karikator I revoles.

Plagosja e tani te ndjerit F. eshte bere nga A. Xh, ndersa ne vendin e ngjarjes kan qen edhe vllau I tij L. Xh dhe fqiu I tij Xh. Sh.

Sipas deshmitarve ngjarja ka ndodhur per shkak te nji borgji.

Kufoma nuk eshte derguar per obduksion, per kete nuk eshte njoftuar ate dite Gjyqtari.

-Shiqimi i raportit mjeksor nga kampi B. ..., sipas te cilit viktima Faruk ishte derguar per ndihme mjeksore ne kete kamp, por qe I njeiti kishte vdekur.

-Fotodokumenetacionin dhe skica mbi vendin e ngjarjes, sipas te cilave shihen gjurme te gjakut, revolja, gezhojat e gjetura ne vendin e ngjarjes.

Ekspertiza balistike lidhur me armët, ku I eshte bere ekspertiza armes, revoles dhe gzhojave te cilat jan gjetur ne vendin e ngjarjes, e cila ekspertize nuk eshte e rendsishme per gjykimin e L. Xh, per shkak se me aktgjykim te gjykates eshte evrtetu, se e ka perdore I akuzuari A. Xh., I cili eshte shpallur fajtor nga Gjykata e Qarkut ne Gjilan.

Mbrojtja e të akuzuarit;

I akuzuari L. Xh, ka deklaruar se Mbetet në tërësi pranë deklaratave të dhënë në shqyrimet e kaluara gjyqësore, poashtu edhe në seanën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 26 Korrik 2016.

Ne jemi pajtuar me fmiljen e viktimës dhe nuk kemi kurfarë problem Vrasja është kryer për një borgj.

Atë ditë ka qenë me vllun A. dh Xh Sh., jan takuar në Viti, por nuk i kujtohet sakt.

Fillimisht ka shkuar në Polici, I'u ka treguar se e ka shit kerrin dhe sun pe gjej kërkun të njejtin . Rastsisht kan hyre në pompë të benzines duke u kthyer për me shku në shtepi, tani të ndjerin e ka parë me makine te pompa, të cilën makine ia ka shitur, ka qenë veturë ... , Nuk e kam ditur që vllau A. e ka pas revolen me vete, as më herët nuk e kam ditur që ka pas allti, as nuk e kam parë kurr.

Nuk e din se pse dikush e mban alltin me vete , unë i urrej armët.

Betohet në zot, se nuk e ka preke me dorë tani të ndjerin F..

Kur kam shkuar te pompa e benzinës dera e veturës ka qenë e hapur, ku kanë qenë 5 vetë me të, i ka thënë F., nëse nuk ka parë kom me udhë për Zvicërr nesër dhe i thashë hajde te avokati ta nënshkrujmë kontratën që e ke ble kerrin prej meje.

Kur i ka mshu grusht tani i ndjeri F., vllaut tim A. ky ka qenë 20 metra larg, e ka degjuar një bërtimë dhe kur është kthyer e ka pa A. rate, ka tentuar me vrapu për me i ndihmu, ndërsa tani i ndjeri F. qenë duke i mshuar. Pastaj policët e kanë larguar prej atyhit, ky pastaj vetëm i kam dëgjuar krismën që kishte shtier A. ndërsa policia duke bërtitur lësho armën.

Ky nuk i ka mshuar F..

Më vjen keq për rastin që ka ndodhur, por nuk kemi pas qëllim. Nuk e ndiej veten fitor.

Fjala perfundimtare e paleve;

Prokurori I shtetit A. U deklaroi; në bazë të provave të shtjelluara të bashkangjitura në shkresat e lëndës, dëgjimit të dëshmtiarve dhe deklaratave të lexuara, sa i përket veprimeve inkriminuese, tani të pandehurit L. qëndrojnë të gjitha tiparet e veprës penale të ndihmës edhe atë: 3 ditë rresht i akuzuari së bashku me të akuzuarin tjetër vllaun e tij A. e kanë kërkuar tani të ndjerin F., rreth një borgji për shitblerjes së një veture, duke vëzhguar atë ditë – ditën kritike me llojin e veturës që e ka pas duke e ngasur tani i ndjeri te pompa e karburantit “...

Fillimisht aty kacafyten tani i ndjeri F. me të akuzuarin A., grushtohen, tani i ndjeri F. e godet me grusht të akuzuarin A. duke e përplase për toke, ashtu që nga mbrapa i akuzuri L. shkon i **ofrohet afër duke e tërhieq dhe kap për fyti, qafe tani të ndjerin F.**, në atë mënyrë që duke i ndihmuar për veprimet e mëtutjeshme tani të ndjerit A. për ndërmarrjen konkret të vrasjes.

Ka kërkuar që i akuzuari Lulzim të shpallet fajtor dhe të denohet me denim meritator sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Blerim Halimi në fjaën përfundimtare deklaroi: pas konsultimeve me të akuzuarin mbetem në tërësi pranë deklaratave të mëhershme duke shtuar se nga provat material por edhe nga dëgjimi i dëshmtiarit B. A konsiderojmë se nuk janë përmbushur elementet e veprës penale për të cilën akuzohet përkatësisht nuk janë përmbushur

elementet e parapara me nenin 24 par 2 të Ligjit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë.

Ka kerkuar lirim in e te mbrojturit te tij.

I akuzuari L. Xh në fjalën përfundimtre deklaroi: përkrahi në tërësi fjalën e mbrojtësit.

Gjykata pasi analizoi provat e administruara dhe mbrojtjen e te akuzuarit, erdhi ne perfundim se nuk ka prova se i akuzuari L. te kete kryer vepren penale e cila i veket ne barre.

Është fakt i pa mohueshëm, se ditën kritike tani i akuzuari L. Xh me vllaun e tij A. Xh, dhe të akuzuarin Xh., gjithashtu të akuzuar në këtë lëndë penale, kan qen prezent në vendin e ngjarjës, te Pompa e Benzines ... në Viti, ku ishin takuar me tani të ndjerin F..

Pas nji mosmarrveshje qe kishin patur rreth nji borgji, i akuzuari A. me të ndjerin F., fillimisht kishin këmbyer disa fjalë fyese, deri sa tani i akuzuari L. Xh ishte duke biseduar me policin B. A tani i ndjeri F. del nga vetura e tij, e sulmon të akuzuarin A. me grushta, të cilin e rrezon për tokë dhe kur degjon L., kthehet kah vllau i tij A. për t'a ndihmuar të ngritet, polici B. A nuk e lejon duke e larguar L.. E deri sa polici është marrë me L., jan dëgjuar disa krisma të revolës, ku A. Xh kishte shtënë në drejtim të tani të ndjerit F., i cili për shkak të plagve të marra kishte ndrruar jetë me vonë pas disa orve.

Pastaj zyrtaret policor B. A e Sh. A. kan nxjerrë armët zyrtare, i kan drejtuar në drejtim të të akuzuarit A., duke e urdhruar që ta leshon revolën në tokë dhe të shtrihet, gjë që e ka bere i akuzuari A..

Këto fakte vërtetohen nga deklarat e dy dehmitarve okular dhe te vetmit B. A e Sh. A qe te dz yzrtar policor, te cilët në mënyrë identike kan deklaruar se L. Xh u kishte dhene shenjë me dorë që të ndalen te vendi i ngjarjes, pastaj ishin informuar nga i njeiti se për cka ka ndodhur mosmarrveshja dhe gjersa ishin duke biseduar me tani te akuzuarin L., tani i ndjeri F. kishte sulmuar me grushta tani te akuzuarin A., me c'rast e kishte rrëzuar për tokë, kurse i akuzuari L. kishte dashur ta ndihmoi vllaun A., por polici B. e kishte ndaluar L. per t'u afruar te A. dhe pas pak qastesh kishin ndëgjuar disa të shtëna me revole, të cilat ishin shkrep nga i akuzuari A., e te cilat e kishin goditur tani të ndjerin F., me c'rast i njeiti ka ndrruar jete ne S. e B.. Për këtë arsye gjykat ua fale besimin ne tersi ktzre deshmitarve, e të cilat deklarat përputhën edhe me deklaratën e të akuzuarit L. Xh.

Sa i përket te akuzuarit L. Xh, i njejt akuzohet për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale vrasje nga neni 30 al.2 pika 3 te LPK-se lidhur me nenin 24 al.2 lidhur me al. 1 te LPJ-se.

Ndihma në kryerjen e veprës penale, do të thot një tërsi e veprimeve me të cilat personi tjetër ndihmohet apo i lehtësohet kryerja e veprës penale. Këto janë veprime me të cilat përgaditet kryerja e veprës penale, siq janë sigurimi-prokurimi i mjeteve për kryerjen e veprës, heqja e pengesave, kontrollimi i vendit ku duhet të kryhet vepra penale, apo veprime që ndermerren gjate kryerjes së veprës penale me të cilat lehtësohet kryerja e sajë, duke i përfshirë edhe veprimet pas kryerjes së veprës penale.

Veprimet e kësajë forme të bashkpunimit konsistojn në ndërmarrjen e veprimeve të tilla me të cilat nuk kryhet vepra penale por vetem ndihmohet kryerja e sajë. Pra veprimet të cilat e përbëjnë ndihmën gjenden jashtë veprimit të kryerjes. Ndihmsi nuk merrë pjesë në veprimet e kryerjes së veprës penale , por vetëm e ndihmon, kontribuon që ajo të kryhet. Në të kundërtën nëse veprimet e ndihmsit në asnjë mënyrë nuk i kanë kontribuar personit tjetër që të kryej veprën penale, atëherë është fjala veëm për tentativën e ndihmës apo ndihmë e pa suksesshme, të cilat Kodi penal nuk i ndeshkon.

Ndihma mundë të kryhet vetëm pasi që personi të këtë vendosur ta kryej veprën penale. Në rast kur veprimet e ndërmerren para se të këtë vendosur personi tjetër të kryej veprën penale , mundë të kualifikohet vetëm si shtytje e jo si ndihmë.

Si ndihmë në kryerjen e veprave penale konsiderohet veqanarisht dhënja e kshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale, venja në dispozicion kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale , menjanimi i pengesave për kryerjen e veprës penale, fsheja e premtuar që me parë e veprës penale, e gjurmëve të veprës penale ose perfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

Në rastin konkret në asnjë mënyrë, nuk është vërtetuar se i akuzuari L. Xh. ta këtë ndihmuar vllauin e tij A. Xh., në kryerjen e veprës penale vrasje, sepse nuk është vërtetuar me asnjë provë, se i ka dhënë mjetin për kryerje-revolen me të cilin është kryer vrasja, nuk ka hequr kurrfarë pengesë që vepra të kryhet me lehtë, nuk i ka dhënë kshilla për kryerjen e veprës penale.

I akuzuari L. Xh të vetmet veprime që i ka bërë në vendin e ngjarjes, ka dalë ju ka dhënë sinjal policisë që ta ndalin veturën, sepse kanë një problem me tani të ndjerin F., u ka treguar policëve se pse e kanë atë problem dhe në një moment deri sa ka qenë duke biseduar me zyrtarin policor B. A., ka vërejtur

vllaun e tij A te rrezuar për tokë, për shkak se tani i ndjeri Faruk e kishte goditur me grushta, ka tentuar që ti ofrohet për ndihmë, por nuk e ka lene polici B..

Pra, këto jan veprimet konkrete qe i ka bërë i akuzuari L. në vendin e ngjarjës, te cilat ne asnji menyre nuk paraqesin ndonji lloj ndihme ne kryerjen e qfardo vepre penale apo eventualisht ndonji veper tjeter penale siq pretendon Gjykata Supreme ne arsyetimin e Aktgjykimit, ku per te akuzuarin L. Xh e kishte kthyer lenden ne rigjykim. Edhe po te egyistonte ndonji veper tjeter penale ne veprimet e te akuzuarit L. Xh, siq eshte pjesmarrje ne rrahje, kjo veper tani eshte parashkruar ne menyre absolute.

Gjithashtu me asnji prove te vetme nuk eshte vertetu konstatimi i Prokurorise ne dispozitivin e katakuzes, se tani i akuzuari L. se bashku me te akuzuarin Xh. Sh ta ken percjelle viktimen per tri dite rresht, ta kene kerkuar para dates 16.05.2001 dhe ate ne Ferizaj dhe Viti, e ne ditën kritike ta ken percjelle viktimen.

Per kete arsye gjykata e ka liruar nga akuza te akuzuarin L. Xh ne mungese te provave.

Shpenzimet lidhur me kete rast, kan mbetur ne barre te mjeteve buxhetore te KGJK-se.

I demtuari I. I nuk eshte udhzuar ne kontest civil, per shkak se i njeiti ka hequr dor nga e drejta e kompenzimit, duke theksuar se gjaku i djalit te tij nuk shitet me te holla.

Sa i perket deklaratave te deshmitarve S. e M. A., gjykata i konsideron te pa rendsishme ne vertetimin e gjendjes faktike.

Provat materiale te administruar gjithashtu ne kete proces gjyqsor, i takojn vertetimit te gjendjes faktike per te akuzuarin A.Xh., perveq Procesverbalit te vendit te ngjarjes, ku thuhet se prezent ne vendin e ngjarjes ka qen edhe i dyshuari L. Xh.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
Më datë: 13.01.2021

Sekretare juridike,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues
Naser Maliqi

KSHILLA JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi, palet e paknaqura munden te ushtrojne ankese ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes ne Gjykatën e Apelit te Kosoves ne Prishtine, nepermes kesaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:055046
Datë: 14.01.2021
Numri i dokumentit: 01406746